



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:014785

Datë: 21.12.2023

Numri i dokumentit: 05106965

C.nr.76/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Shqipe Sejdiu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses H. S., nga M., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Leutrim Ademi dhe Sheremet Ademi, avokat me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Gjejlan Pasoma, avokat me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensimi i shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 481.98 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datën 21.12.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M
(NË BAZË TË POHIMIT)

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses H. S., nga M., nga Komuna e Mitrovicës.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Mitrovicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës në vlerë të 100 % të një page bazë t’ia paguaj shumën prej 481.98 €, me kamatë ligjore prej 8 %, e cila do të llogaritet nga data 25.01.2021 kur është parashtruar padia e deri në pagesën definitive, dhe atë në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

III. APROVOHET PJESERISHT si e bazuar kërkesa sa i përket shpenzimeve te procedurës ne shumën prej 124 euro deri në pagesën e tërësishme të gjitha në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit nene kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET PJESËRISHT si e pa bazuar përtej pjesës se aprovuar si në piken III te dispozitivit te këtij aktgjykimi kërkesa e paditësve sa i përket shpenzimeve te procedurës kontestimore, me te cilën kane kërkuar nga e paditura qe ne emër te precizimit te kërkesëpadisë si dhe kërkesën drejtuar Komunës t’ua paguaj shumën prej 164 euro.

Arsyetim

Paditësi, me datën 25.01.2022, pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padi, e të precizuar përmes parashtrësës të datës 22.11.2023, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës, Drejtoria Komunale e Arsimit, me anë të së cilës kanë kërkuar që të obligohet e paditura t’i paguaj në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar paditëses H. S., nga M., për 30 vite përvojë pune në vlerë të 100% të një page bazë t’ia paguaj shumën prej 481.98 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data 25.01.2022, datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto

(borxhin kryesor dhe kamatën) në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata me datën 02.12.2023 ka nxjerr aktvendim për përgjigje në padi duke e paralajmëruar edhe me pasojat procedurale se nëse nuk paraqet përgjigje në padi në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit të lartpërmendur, gjykata do të merr aktgjykim në bazë të pa dëgjueshmërisë/mosbindjes.

E paditura aktvendimin e lartcekur e ka pranuar me datë 11.12.2023 (konfirmuar përmes fletëkthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës), kurse në përgjigjen në padi të datës 15.12.2023, ka pohuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses. E njëjta ndër të tjera ka theksuar se meqenëse paditësit kanë bashkangjitur prova me anë të të cilave vërtetojnë se është e punësuar pranë te paditurës dhe ka bashkangjitur prova me anë të cilave dëshmojnë ditët e pranisë ne pune për periudhën kohore gjate se cilës e kane kërkuar kompensimin e shpërblimit jubilar, andaj në bazë të kësaj e paditura e pohon kërkesëpadinë e paditëseve dhe kërkon nga gjykata që te njëjtën ta aprovojë ne tërësi si të bazuar. Ndërsa sa i përket kërkesës për kompensimin e shumës prej 289 euro për precizimin e padisë e njëjta te refuzohet si e pa bazuar pasi që me tarifën e OAK nuk parashihet për përpilimi te parashtrave te precizimit te padisë.

Gjykata në kuptim të nenit 148.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me të cilin parashihet se *“Në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)”*, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata aprovoj pjesërisht shpenzimet e procedurës kontesimore si ne piken III te dispozitivit te këtij aktgjykimi ne mbështetje të nenit 452 të LPK-së, ashtu që detyrohet e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padis shumen prej 104 euro për taksen për padi shumen prej 20 euro gjithsej prej 124 euro- sipas tarifës së OAK.

Gjykata refuzoj si te pa bazuar si ne piken IV te këtij Aktgjykimi, kërkesën për shpenzimet sa i përket precizimit të kërkesëpadisë ne shumen prej 104 euro pasi që njëjta konsiderohet petitum i padisë, po ashtu refuzoj edhe shumën prej 60 euro lidhur me kërkesën e përpiluar drejtuar te paditurës pasi që nuk është e paraparë me tarifën e OAK-së

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.76/2022, datë 21.12.2023

Gjyqtari
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit se të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.